



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 12.5.2023

Nr: 501

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

KRIJIMIN E KQV-SË SË POSAÇME DHE SASINË E FLETËVE TË VOTIMIT PËR QENDRËN E POSAÇME TË VOTIMIT NR. 2565/01, KZAZ NR.45, BASHKIA BELSH, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenit 43, nenit 62, pika 2 dhe nenit 93, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 45, Bashkia Belsh me shkresën nr. 5042 prot., datë 12.5.2023, “Për ngritjen e KQV-së së posaçme”, i propozon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, krijimin e Komisionit të Qendrës së Votimit të Posaçme nr.2565/01 të IEVP Lushnjë (burgu i Kosovës).

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë administruar 24 vendime për 24 shtetas, të administruara nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për dhënien e të drejtës për të votuar personave të paraburgosur dhe të dënuar, që ndodhen aktualisht në IEVP Lushnjë, të cilët kanë të drejtë vote por nuk figurojnë në listën përfundimtare të zgjedhësve, të QV nr. 2565/01.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve duhet të autorizojë KZAZ nr.45, Bashkia Belsh, që të krijojë komisionin e kësaj qendre votimi dhe të marrë masat për të siguruar fletët e votimit të QV nr. 2565/01, nga qendrat e tjera të votimit të KZAZ-së nr. 45, me procesverbale.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 43, nenin 62, pika 2 dhe nenin 93, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

Data: 12.5.2023 Nr: 501
Ora: 12:00



“Për krijimin e KQV-së së posaçme dhe sasinë e fletëve të votimit për qendrën e posaçme të votimit nr. 2565/01, në KZAZ nr. 45, Bashkia Belsh, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

V E N D O S:

1. Autorizimin e KZAZ-së nr. 45, Bashkia Belsh, që me vendim të krijojë dhe emërojë Komisionin e Qendrës së Votimit të Posaçme nr. 2565/01.
2. Autorizimin KZAZ-së nr. 45, Bashkia Belsh, të marrë 30 fletë votimi për kryetar dhe 30 fletë votimi për këshill nga QV nr. 2565/00.
3. KZAZ nr. 45, Bashkia Belsh, të marrë masat që QV nr. 2565/01, të pajiset me fletët e votimit nga QV-ja e cituar në pikën 2.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të KQZ-së.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI